

Lejla SHAHU(DOBI) Ekspert Kontabel i Rregjistruar, Lic.174 date 22/01/2008

## **RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**

***PER FONDET E PERFITUARA DHE SHPENZIMET E KRYERA***

***NGA PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE***

***PER VITIN KALENARIK 2016***

## PERMBLEDHJE E LENDES

- Raporti i Audituesit te Pavarur
  - Shenime mbi Deklaratat Financiare
1. *Te pergjithshme*
  2. *Politikat operuese*
  3. *Rregullat e vleresimit*
  4. *Te ardhurat*
  5. *Shpenzimet*
  6. *Likuiditetet*
  7. *Kreditorët e palikujduar*
  8. *Dokumentacioni dhe rregjistrimi i fondeve jo publike*
  9. *Ngjarje te mevonshme*

## **RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU**

**Drejtuar :** -Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:  
Rruga Ibrahim Rugova, nr.4 , Tirane  
-Partise Agrare Ambjentaliste e Shqiperise  
Rruga "Budi", nr.16, Tirane

### ***Te nderuar Zoterinj:***

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor i RSH"i ndryshuar, ne zbatim te Vendimit te KQZ 196 date 03/05/2017 si dhe Kontraten e Sherbimit nr.5484/23 date 18/09/2017 te lidhur me kete institucion, kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur per fondet e perfituara dhe shpenzuaranga Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise (qe do ti referohemi ne vijim me inicialet PAA) për vitin kalendarik2016.

### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Pergatitja e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzuara nga PAA gjate vitit kalendarik 2016 eshte pergjegjesi e drejtimit te saj.

### **Pergjegjesia e Audituesit**

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, SNA 800 "Mbi angazhimet e auditimit per qellime te vecanta". Keto standarte kerkojne qe auditimi te planifikohet dhe te kryhet per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.



3

Lejla SHAHU(DOBI) Ekspert Kontabel i Rregjistruar, Lic.174 date 22/01/2008

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, të fakteve dhe dokumenteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Ai përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabel të ndjekura, vlerësimet e rëndësishme të bera nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së fondeve të arketuara dhe shpenzuara për vitin kalendarik 2016.

Në çmujmë se auditimi ynë përben një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë mbi Pasqyrat Financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, për vitin 2016.

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se, përveç shënimit 6/a, Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, gjatë vitit kalendarik 2016, japin një pamje të vertetë dhe të sinqertë.

**Lejla SHAHU (DOBI) ,**  
**Ekspert Kontabel i Rregjistruar**  
**Lic.174 date 22/01/2008**  
**Adresa : Rr. Islam Alla, P.67/9, Tirane**

LEJLA DOBI  
Eksperte Kontabel e Autorizuar  
TIRANE - ALBANIA  
Date 10 Nentor 2017

**SHENIME TE AUDITUESIT TE PAVARUR MBI DEKLARIMET FINANCIARE TE  
PARTISE AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPERISE, GJATE VITIT KALENDARIK**

**2016.**

**1. Te pergjithshme**

Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise (PAA), eshte rregjistruar me Urdher te Ministrise se Drejtesise nr.22 date 09/02/1991 dhe me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.3417 date 21/07/2013, President i saj eshte Z. Agron Duka. Partia operon me NIPT K72314451G.

**Organizimi dhe drejtimi**

Organet e PAA jane:

- Konventa e Partise;
- Kryetari i Partise;
- Asambleja Kombetare;
- Kryesia e Partise;

**Burimet e financimit te Partise jane:**

Burimet financiare te partise, me qellim realizimin e synimeve politike e sociale, perbehen nga kuotizacionet e anetaresise, te ardhurat nga buxheti i shtetit dhe financime te tjera private. Sipas ligjit per partite politike te gjitha financimet regjistrohen ne nje regjister te posacem i cili administrohet nga krye-financieri i partise (neni 41 i statutit te PAA).

**Selia e Partise eshte ne adresen Rr.Budi nr 6, Tirane.**



**2. Politikat operuese**

Drejtimi i Partise, ka operuar per kete periudhe qe auditojme ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2009 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, ligjin 8580 date 17/02/2000 "Per partite politike" i ndryshuar, dhe ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i dates 29.04.2004, dhe ne konformitet me aktet nenligjore, me objektin e veprimtarise per te cilin eshte krijuar, dhe programit te caktuar nga organet qendrore.

**3. Rregullat e vleresimit**

**-Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare**

Bazuar ne auditimin e kryer, rezulton se te ardhurat jane evidentuar e deklaruar ne baze te arketimeve faktike, kontabiliteti eshte ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit, duke zbatuar parimin e kujdesit, nderkohe qe shpenzimet jane evidentuar e deklaruar ne ne momentin e kryerjes se tyre.

Administrimi i fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera eshte kryer nga selia qendrore, per rrjedhoj edhe pasqyrat financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera gjate vitit 2016, jane pergatitur nga selia qendrore e PAA.

**-Monedha e raportuar**

Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbajtur bazuar ne dokumentacionin fillestar ne monedhat All dhe kontribute ne natyre. Pasqyrat jane pergatitur ne Leke.

**-Taksat dhe Kontributet .**

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia nuk ka patur asnje te punesuar gjate vitit 2016 dhe per rrjedhoje nuk ka evidentuar dhe paguar taksat qe rrjedhin nga puna.

**4. FONDET E PERFITUARA NGA PAA GJATE VITIT KALENDARIK 2016.**

N R	Burimet e perfitimit te fondeve per vitin 2016	Shenime	Vendi i depozi timit	Lloji i monedhes			Kurs i	Total ne leke
				Leke	Monedhe te huaj	Ne natyre		
1	Buxheti i shtetit	a		0	0	0		0
2	Burimet e veta (kuotizacione)	b		0	0	0		0
3	Dhurimet	c	Arke	1,655,000	0	479,100		2,134,100
4	Kredite	d		0	0	0		0
5	Te tjera	e		0	0	0		0
	<b>TOTALI PAA</b>			<b>1,655,000</b>	<b>0</b>	<b>479,100</b>		<b>2,134,100</b>

**4.a Buxheti i Shtetit**

Partia Agrare Ambjentaliste nuk ka perfituar fonde nga Buxheti i Shtetit ne formen e ndihmes financiare per vitin 2016, sipas vendimit te KQZ-se nr.1 date 05/02/2016.

**4.b Burime te Veta**

Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise, nuk ka patur fonde nga burimet e veta (kuotizacione), per vitin 2016.

**4.c Dhurimet.**

Gjate vitit 2016, Partia Agrare Ambjentaliste ka arketuar dhurime ne total 1,655,000 nga 37 persona fizike, te cilet kane dhuruar shuma me vlere me te vogel se 100,000 leke. Keto te ardhura jane arketuar ne arken e Partise. Partia ka mbajtur rregjistrin e dhurimeve duke identifikuar qarte identitetin e dhuruesve, te cilet kane nenshkruar deklaratat individuale te dhurimit, ne perputhje me Ligjin 10019 date 29/12/2008 "Kodi Zgjedhor ne RSH", neni 90 pika 1 e saj.

Gjithashtu Partia Agrare Ambjentaliste, gjate vitit 2016, ka rregjistruar ne formen e dhurimit ne natyre shumen 479,100 leke, e cila i referohet faturave tatimore te leshuara nga shoqeria shqiptare "Go Tech" e cila ka dhene ne favor te PAA pa pagese: paisje zyre.



#### 4.d Kredite.

Partia Agrare Ambientaliste e Shqiperise, nuk ka përdorur fonde nga kredite, per vitin 2016.

#### 5 SHPENZIMET

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Shuma e fatures	Shpenzime te papaguara	Totali i shpenzimeve
1	Abcom: shpenzime internet, telefoni	5.a	Arke	77,167.75	0	77,167.75
2	Bashkia Tirane: taksa vendore	5.b	Arke	117,407.00	0	117,407.00
3	KQZ sekuestrime,zhdemtime	5.c	Arke	685,687.00	0	685,687.00
4	Drejtoria e sherbimeve qeveritare: salla me qera etj.	5.d	Arke	592,200.00	0	592,200.00
5	OSHEE shpenzime energji elektrike	5.e	Arke	29,767.20	0	29,767.20
6	Go Tech	5.i	Arke	0	479,100.00	479,100.00
7	Te tjera	5.j	Arke	62,475.44	0	62,475.44
	<b>Totali</b>			<b>1,564,705.39</b>	<b>479,100</b>	<b>2,043,804.39</b>

Totali i shpenzimeve te kryera nga PAA, per vitin 2016, eshte 2,043,804.39 leke, nga te cilat jane paguar per shpenzime 1,564,705.39 lek dhe diferenca 90,294.61 lek jane gjendje ne arken e Partise ne date 31/12/2016. Vlera 479,100leke eshte dhurim ne nature e evidentuar ne burimet e ardhurave te partise per vitin 2016.

Lidhur me shpenzimet e mesiperme, u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjitha elementet e mesiperme, dhe u siguruar se:

Jane te mbajtura ne dokumentacion te rregullt ligjor te njohura nga ligjet ne fuqi si ai per kontabilitetin dhe ato fiskale.

Klasifikimi i tyre dhe paraqitja ne pasqyren financiare eshte i sakte, duke dhene nje imazh te qarte mbi destinacionin e perdorimit te tyre.

Nga shpenzimet e kryera e te ekspozuara ne pasqyren e mesiperme, vlen te japim disa shpjegime te shkurtra per secilin elementet, si :





**5.a Shpenzime internet telefoni.**

Gjate vitit 2016, jane shpenzuar per internet e telefoni shuma 77,167.75 leke. Pagesa eshte bere me arke, kunderjet faturave tatimore dhe kuponave tatimore, nga shoqeria Abcom shpk.

**5.b shpenzime taksa vendore**

Jane paguar 177,407 leke per taksat vendore me Bashkine Tirane. Pagesa eshte bere me para ne dore kundrejt faturave tatimore dhe kuponeve tatimor te leshuar nga shitesi i sherbimit.

**5.c shpenzime sekuestrike e zhdemtime**

Shuma e ketij shpenzimi eshte 685,687 leke, pagesa eshte bere me arke. I referohet kthimit te shumave paradhenje nga Buxheti i Shtetit, te marra nga vitet e kaluara.

**5.d shpenzime salla me qera etj.**

Shuma e ketij shpenzimi eshte 592,200 leke, pagesa eshte bere me arke. I referohet faturave tatimore te leshuara nga Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare per sallat e marra me qera dhe eventet e organizuara nga PAA ne Pallatin e Kongreseve, per vitin 2016.

**5.e shpenzime energji elektrike.**

Shuma e ketij shpenzimi eshte 29,767.20 leke, pagesa eshte bere me arke. I referohet faturave tatimore te leshuara nga OSHEE per energji elektrike te shpenzuara nga PAA per vitin 2016.

**5.i shpenzime Go Tech.**

Shuma e ketij shpenzimi eshte 492,100 leke, eshte shpenzim me kushtin e dhurimit. I referohet faturave tatimore te leshuara nga shoqeria shqiptare "Go Tech" per paisje zyre, pa pagese.

**5.j te tjera.**

Shuma e ketij shpenzimi eshte 62,475.44 leke, pagesa eshte bere me arke. I referohet faturave tatimore te leshuara nga shoqeria "Aldo Tours" Kavaje ne shumen 25,000 leke dhe blerjes se vules se partise ne shumen 36,400 leke, si dhe komisione ne shumen 1,075.44 leke

**5.k paga, siguracione dhe qera zyre**

Partia PAA nuk ka te punesuar me kohe te plote apo te kontraktuar, partia operon me individe te cilet ofrohen per te ndihmuar ne punet e partise kur eshte e nevojshme.

Gjithashtu partia per seline e saj ne adrese rr. Budi nr.6 nuk ka kontrate qeraje, por ka kontrate perdorimi.



## 6 LIKUJDITETET

### 6/a Gjendja e likuiditeteve ne fund te periudhes

Pershkrimi	Monedha	Kursi	vlera lek	Vlera eur	Totali ne lek
Arka	Leke	1	90,294.61	0	90,294.61
Banka	Leke		S'ka	0	S'ka
<b>Totali</b>			<b>90,294.61</b>	<b>0</b>	<b>90,294.61</b>

Partia Agrare Ambientaliste ka kryer pagesat e shpenzimeve te mesiperme duke perdorur vetem parane cash, nepermjet arkes se partise.

**Partia PAA nuk ka nje llogari bankare** prane nje banke te nivelit te dyte qe te veproje ne emer dhe per llogari te saj. Kjo eshte ne kundërshtim me ligjin 9920 date 19/05/2008 "Per procedurat tatimore ne RSH" neni 59 pika 1 "pagesat me para ne dore", qe detyron te gjithe tatimpaguesit te realizojne pagesat e transaksioneve mbi 150.000 leke nepermjet llogarive bankare.

## 7 KREDITORE TE PALIKUJDUAR:

Nuk ka kreditor te pa likuiduar.

## 9 NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Lejla SHAHU (DOBI)

Ekspert Kontabeli Rregjistruar

Licence nr.174 date 22/01/2008

Adresa: Rr. Islam Alla, P.67/9, Tirane

Date 10 Nentor 2017

